

URDHËR
Nr. 43, datë 24.1.2019

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 28, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj ministrie, z. Oltjon Muzaka.
 2. Kompetencat e deleguara të titullarit të autoritetit kontraktor të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë do të ushtrohen për një periudhë të përcaktuar nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, në zbatim të dispozitave ligjore për prokurimin publik.
 3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini